




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Skupština Opština
Municipal Assambly
01-Nr.464/01-18030/2018

DREJTORIA PËR URBANIZËM,KADASTËE DHE MBROJTJE TË MJEDISIT

DATE/A:	12.07.2018
REFERENC-Ë:	
PËR/ZA/TO:	
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	DUKMM-Drejtori Ukshin Çallaki
NGA/OD/FROM:	Spektori i Pronës,Zyrtari për Shpronësim, Hamza Berisha
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim Preliminar për Shpronësim

Në bazë të nenit 10,paragrafi 1 dhe 1.1 .konform nenit 4 të Ligjit për Shpronësimin e pronës së palujtshme.Ligji Nr.03/ L-139 dhe Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Shpronësimin e pronës së palujtshme,Ligji Nr.03/L205 dhe nenit 13,82 dhe 109 të Ligjit për procedurën administrative,Nr.02/L-28 si dhe shqyrtimit të komenteve,deklaratave dhe mendimeve të shprehura në dëgjimin publik të datës 28.07.2017 ,mbrenda afatit ligjor merr:

VENDIM PRELIMINAR

I.MIRATOHET kërkesa e Drejtorisë për Urbanizëm,Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit e Komunës së Kaçanikut të datës 15.02.2018 për Shpronësimin e pasurisë së palujtshme për zgjerimin e Vorrezave të Dëshmorëve dhe ndërtimin e rrethojës sipas projektit dhe ate:

I. Parcela kadastrale nr.00246-2,me kulturë mal i kl.1,në sipërfaqe prej 3788 m2 ,Zona Kadastrale Soponicë ,në emër të Esat Xhemal Guri nga f.Nikaj.

II.VËRTETOHET se është i domosdoshëm dhe i ligjshëm shpronësimi i parcelës kadastrale kadastrale për zgjerimin e Vorrezave të Dëshmorëve si dhe ndërtimi i rrethojës.

III.Vendimin preliminar pas miratimit,organi shpronësues tia dërgon pronarëve-zotëruesve të pronave dhe personave tjerë që pretendojnë se ju takon e drejta në pronën që do të shpronësohet.Vendimi preliminar hyn në fuqi ditën e shpalljes,në bazë të nenit 4 dhe 43 të Ligjit për shpronësim.

IV.Drejtoria për urbanizëm,Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit do ti bëjë ndryshimet në operatin kadastral sipa këtij Vendimi.

Arsyetim

Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit ka paraqitur kërkesë 01-Nr.464/01-4965/2018, të datës 15.02.2018, me të cilën ka kërkuar iniciimin e procedurës së shpronësimit të pasurisë së palujtshme të përshkruar në dispozitiv të vendimit preliminar, me qëllim të arritjes së qëllimit të ligjshëm publik për vazhdimin e projektit të ndërtimit -rregullimit të Vorrezave të Dëshmorëve. Kërkesës i është bashkangjitur i gjithë dokumentacioni i nevojshëm me nenin 8 në lidhje me nenin 4 të Ligjit për shpronësimin dhe se ky shpronësim është me karakter të interesit të përgjithshëm dhe në funksion të ngritjes së infrastrukturës .

Organi Shpronësues-Kryetari Komunës, ka miratuar kërkesën e Drejtorisë për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit për iniciimin e procedurës së shpronësimit. Me datë 15.06.2018 të gjithë pronarët juridik-zotëruesit e interesit të pronës së palujtshme janë deklaruar rreth procedurës së shpronësimit, nga kjo që u theksua më lartë shihet se janë plotësuar kushtet ligjore për iniciimin e procedurës së shpronësimit dhe se kërkesa është e bazuar, andaj më afër u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Vendimi, pala e paknaqur ka të drejtë ankese mbrenda 15 ditëve, në Gjykatën kompetente, nëpërmjet organit shpronësues-Kryetari i Komunës.

Vendimi i dërgohet:

1. Paraqitësit të kërkesës,
2. Poseduesit juridik-zotëruesit të interesit të pronës,
3. Gazetës zyrtare të Kosovës dhe një gazete ditore me tirazh më të madh.



Organi Shpronësues
Kryetari i Komunës
Besim Ilazi

Lista e parcelave kadastrale të parapara për shpronësim për projektin e Vorrezave të Dëshmorëve.

Nr. Ren	Emri dhe mbiemri i pronarit	Nr. I parc. Kat.	Kultura	Klasa	Zona Kat.	Sip. e Përgjith.	Shpronësimi sipas projektit				
							Kultura	Klasa	Sip. për shpronësim	Sendet aksesore	Vërejtje
1	Esat Xhemal Guri nga f.Nikaj	00246-2	Mal	2	Soponicë	3788 m2	mal	2	3788 m2	-	-